

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“BitScript Solutions” sh.p.k**

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 01/03/2023, Themeluesi:

1. **Silva Bregu**, lindur në Fier më 18/02/1994, banues në Tirane, me leternjoftim nr personal **J45218056S**.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjisacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

**Neni 1-Emërtimi**  
Emërtimi i shoqërisë është

**“BitScript Solutions” sh.p.k**

**Emri tregtar i shoqerise : “BitScript Solutions” SHPK**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëhënë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

**Neni 2-Vëndndodhja e selisë**

**Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet:** Tiranë, Yzberisht, Rruga Rexhep Shala Pallati Unikut, kati 9 apartamenti 1.

**Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.



#### Neni 4- Objekti i veprimtarisë

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

**1. Në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë:** Aktivitete implementuese, menaxhuese te sistemeve Database, Middleware. Analize, Projektim, Zhvillim i sistemeve ERP; Analiza, Suport i sistemeve CRM; Analiza e kerkesave te sistemeve software; Projektim, realizim, menaxhim, mimbajtje e programeve software dhe sistemeve informatike. Programimi dhe zhvillimi i sistemeve softwar ku perfshihen kodimi, instalimi, integrimi i te gjithe komponenteve me sisteme te jashtme, dokumentimi, korigimi.

#### Neni 5- Kapitali Themeltar

**Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 (Njëqind mijë) lekë.**

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (një) pjesë kapitali me vlerë nominale 100.000 (Njëqind mijë) lekë.

#### Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

- 1) **Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 (Njëqind mijë) lekë.**

Kapitali themeltar është i perbërë nga 1 (një) pjesë kapitali me vlerë nominale 100.000 (Njëqind mijë) lekë

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortaket e shoqerise perkatesisht:

1. **Silva Bregu**, lindur në Fier më 18/02/1994, banues në Tirane, me leternjoftim nr personal **J45218056S**, vlera e kapitalit te pergjithshem **100.000** Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlerë te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

#### Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqeritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

### Neni 8- Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrëthanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
2. **Administratori i vetem i shoqërisë është Znj. Silva Bregu**, lindur në Fier me 18/02/1994, banues në Tirane, me leternjoftim nr personal **J45218056S**.
3. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregistrohet në rregjistrin tregtar.

### Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### Neni - 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve per ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksonit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### Neni - 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Tirane , më 01/03/2023.*

## ORTAKET E SHOQERISE

Silva Bregu

